



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 112, datë 10.12.2009**

**MBI  
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E SHOQËRISË “INSIG”  
SH.A**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/gj, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 55, të Ligjit nr. 9267 datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Ministrisë të Financave si aksionar i vetëm i shoqërisë “INSIG” sh.a, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 6, të statutit të shoqërisë së sigurimit “INSIG”sh.a si pasojë e zvogëlimit të kapitalit, më përmbajtje si më poshtë:

*“Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.020.000.000 lekë, i ndarë në 1.700 aksione me vlerë nominale 600.000 lekë secili, tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga aksionarët. Aksionet e shoqërisë zotërohen në masën 100 % nga Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministri i Financës”;*

2. Miratimin e ndryshimeve të tjera në statutin e shoqërisë “INSIG” sh.a, sipas materialit bashkëlidhur.
3. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR  
Elisabeta GJONI**